



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlaza - Outgoing		
02	No.Nr. 20-22	
Tarih/Dt.		04.03.2022

Referenca : 626-21-027-1-1-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01, neni 18, dhe neni 41 në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 8 paragrafi 8.1 dhe pika 8.1.1 bie këtë:

V E N D I M

I

Refuzohet si e **pa bazuar** kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “**MATKOS PHARM**” SH .P.K. - **PRISHTINË** e parashtruar me datën 03.03.2022 përmes platformës së prokurimit për aktivitetin e prokurimit me nr. **626-21-10608-1-1-1** nr. të brendshëm **626-21-027-1-1-1** dhe titull: “**FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË**”

II

Vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 28.02.2022 me të cilin është shpërblyer me kontratë **Grupi i Operatorëve Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX.IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K.**

. III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik “**MATKOS PHARM**” SH .P.K. me datë 03.03.2022 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës.

Si Autoritet Kontraktues, pas pranimit të kërkesës brenda afatit ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga O.E. “**MATKOS PHARM**” SH .P.K. i cili në deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet pretendon se janë shkelur

dispozitat ligjore të LPP-s të parashikuara në nenet: 59 si dhe Kërkesat e përshtatshmërisë 6.4 pika 4 të dosjes së tenderit dhe mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2.

Si autoritet kontraktues në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Operatori Ekonomik ankues ka cekur se në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktues është paraqitur kërkesa si vijon: 4) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar tatimin në pronë në vendin e themelimit të biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Si dëshmi është kërkuar: 4) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jetë më i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri në datën e hapjes së ofertave.

Pretendimi i O.E. ankues është se anëtarë i O.E. të rekomanduar nuk e ka dorëzuar këtë vërtetim apo certifikatë, andaj në mungesë të këtij vërtetimi, ky grup i O.E. është i pa përgjegjshëm.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek Kërkesat e përshtatshmërisë neni 6.4 pika 4 është cekur se dëshmia për vërtetimin e pagesës së tatimit në pronë kërkohet **vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës** dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete më i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri në datën e hapjes së ofertave. Pasi ka rekomanduar komisioni i vlerësimit që Grupi i Operatorëve Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. & KEIS (KOSOVA EX.IMP. SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K. të shpërblehet me kontratë për procedurën e prokurimit në fjalë, për arsye se ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët me poentim, në mesin e tenderuesve pjesëmarrës, duke u bazuar në nenin 47 paragrafi 47.31 të RROUP në datën 21.02.2022 përmes platformës elektronike kemi kërkuar që brenda afatit prej 6 (gjashtë) ditëve përkatësisht deri në datën 28.02.2022 ora 13:30 të na sillen dokumentet për të dëshmuar përshtatshmërinë e pranueshmërisë sikur është cekur në nenin 6.4 të FTD-së.

Me datën 23.02.2022 grupi i O.E. i rekomanduar, përmes platformës elektronike ka ofruar dokumentet me afat të vlefshëm, nga të cilat vërtetohet se është i pranueshëm sipas kërkesave të parapara, andaj i ka plotësuar kërkesat në fjalë. Sa i përket këtij pretendimi konsiderojmë që është pretendim i pa bazë.

Edhe pretendimi se është shkelur neni 59 është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm, pasi që në dispozitat e këtij neni në paragrafin 4 është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në dosje të tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 të FTD-s është paraparë që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë realizuar kontrata të **ngjashme** së paku 270,000.00€ gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Si dëshmi është kërkuar: Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë titullin e furnizimeve të përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. Komisioni i vlerësimit e ka bërë vlerësimin në mënyrë profesionale duke ju përmbajtur dispozitave të nenit 59 të LPP-s pasi që vlerësimin e ka bërë në bazë të kërkesave të paraqitura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

O.E. ankues pretendon se kontratat e realizuara nga grupi i O.E. të rekomanduar për kontratë, nuk kanë të bëjnë me furnizim të barnave por pajisjeve apo makinerive mjekësore. Duet të sqarojmë që kërkesa e Autoritetit Kontraktues e paraqitur në neni 9.1&9.2 të FTD-s ka qenë që O.E. duhet të ketë realizuar kontrata të **ngjashme dhe jo kontrata të natyrës së njëjtë (vetëm për barëra)** andaj me qenë se nga grupi i O.E. të rekomanduar janë paraqitur dëshmi se kanë realizuar kontrata në vlerë prej 270,000.00 € konsiderojmë që ky grup i ka plotësuar në tërësi kërkesën e Autoritetit Kontraktues të paraqitur më lartë.

Ndërsa sa i përket pretendimit se lideri i grupit posedon vetëm 2 kontrata të realizuara në shumë simbolike prej 4,608.34 euro që kanë të bëjnë me furnizimin me barna, është e vërtetë, mirëpo qëllimi i grupit është që të bashkohen për të realizuar kontratën. Në deklaratën e grupit anëtarët kanë konfirmuar se janë bashkërisht dhe veç e veç përgjegjës për realizimin e kontratës andaj në këtë rast e plotësojnë njëra tjetrën për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm.

Ndërsa sa i përket dilemës se kontratat e realizuara për pajisje medicinale nuk janë të ngjashme me tenderin në fjalë sepse krejt diçka tjetër janë pajisjet mjekësore dhe krejt diçka tjetër barnat, një çështje të tillë e sqaron vetë licenca e lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale të cilat janë paraqitur nga grupi i O.E. si dhe nga vetë Operatori Ekonomik "Matkos Pharm" sh.p.k. si Qarkullues me shumicë për **produkte dhe pajisje medicinale** e cila nënkupton që edhe barërat edhe pajisjet janë produkte medicinale prandaj konsiderojmë që pa dyshim, kontratat janë të natyrës së ngjashme.


Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë si dhe në dispozitat në fuqi të Legjislacionit të Prokurimit Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me dt. 04.03.2022

Në M a m u sh ë

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.

Shtojcë: 1. Kërkesa për dokumentet e pranueshmërisë e datës: 21.02.2022 dhe 2. Vërtetimi i tatimit në pronë i datës 22.02.2022 të lëshuar nga Komuna e Prishtinës.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Mamushë me 21.02.2022

Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit Rruga “Sahat Kulesi” nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës

Për: Grupin e Operatorin Ekonomik: “MEDPLUS”SH.P.K, KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY) SH.P.K, Rr.Pranvera e Lirisë,10000, Prishtinë.

Nr. i prokurimit	626-21-10608-1-1-1
Nr i brendshëm	626-21-027-1-1-1

Titulli: “Furnizimi me Barëra për QMF-n në Mamushë

I nderuar, Z. Jeton Prenaj

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë për tenderin me nr. të prokurimit dhe titull të cekur si më lartë, janë paraparë kërkesat si vijon:

2. Një vërtetim origjinal (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata Ekonomike ose autoriteti kompetent në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik.
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.
4. Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi me të cilin dëshmohet se O.E. ka paguar tatimin në pronë së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Dokumentet e lartcekura, kanë qenë të parapara si obliguese vetëm për Operatorin Ekonomik të cilin Autoriteti Kontraktues mendon që ta shpërblejë me kontratë i cili duhet ti paraqesë këto dokumente para vendimit për dhënie të kontratës.

Andaj, me qenë se komisioni vlerësues ka rekomanduar që ju të shpërbleheni me kontratë, për arsye se ju si Grup i Operatorve Ekonomik, keni ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit, ndërsa në tenderin tuaj keni dorëzuar dokumentet si më poshtë:

- dokumentet të kërkuara në pikë 2, 3 dhe 4, janë dorëzuar nga ana e O.E “MEDPLUS” SH.P.K, por dokumentin me nr.4 e keni dorëzuar me afat të skaduar, ndërsa O.E KEIS i cili është antar i grupit ka dorëzuar vetëm dokumentin e kërkuara në pikën 2 dhe 3 por nuk e ka dorëzuar dokumentin në piken 4, ndërsa dokumenti me nr.2 ka qen me afat të skaduar, pra kerkojm qe te na sjellni dokumentet ne piken 2 dhe 4.

Prandaj kërkojmë që brenda afatit prej 6 (Gjashtë) ditëve nga data e kësaj kërkesë përkatësisht deri me datën 28.02.2022 ora 13:30, të na sillni tek ne të skanuara përmes platformës elektronike, e-mailit ose kopje fizike, dokumentin e kërkuara në pikën 2 dhe 4 në emër të Grupit të Operatorve Ekonomik: “MEDPLUS”SH.P.K, KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY) SH.P.K,

Vërejtje: Dështimi eventual për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara më lartë, do të na detyroj që të ua refuzojmë tenderin tuaj, dhe do të vazhdojm me operatorin e dytë me radhë për nga çmimi më i ulët si dhe do të iniciojmë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.

Ju faleminderit për mirëkuptim.

Për çdo informatë mos hezitoni të më kontaktoni në nr. tel.

Fix: 038 200 45 211

Fax: 029 273 048


email: gazmend.gashi@rks-gov.net

Me respekt,

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of
Komuna e PRISHTINË / Opština PRIŠTINA / Municipality



Bazuar në nenin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrim të pagesës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za poreza na imovinu i administrativne uredbe MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No 10-430/03-0037541/22
9672199846

22/02/2022

VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi
Kojim se potvrđuje da je poreznik
that certifies that taxpayer

BESART MUHARREM SHALA

PRISHTINË

Komuna / Opština / Municipality

PRISHTINË HAMDI GASHI PN

adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë
Delimično/ izveršio uplatu poreskih obaveza
has partially / fulfilled obligations on property tax

KEIS PHARMACEUTICAL SH.P.K.

Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtev / Certificate is issued by

Shërbime të ZKK

dhe shërben për / i služi za / and is used for

PËR TENDER NR 810519621

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info

